

# KOSOVARJA

Ballina: Habibe Duraki

Po iku KFOR-i,  
unë para tyre

Minatorët  
e "Trepçës"  
s'i bën kush hesap

Politizimi i Akademisë  
së Shkencave dhe Arteve  
të Kosovës

## HABIBE DURAKI


E PARA GRUA SHQIPTARE  
ME POST TË LARTË POLITIK  
NË BELGJIKË



"I vdekuri"  
pas 24 vjetësh  
paraqitet  
i gjallë

Jam në zor  
nga burrat  
e martuar

50 vjet jetë,  
1 muaj martesë





**BLACK**  
*Zbrinjje*  
**FRIDAY**

**30%**

**50%**

**70%**

NË TË GJITHA ARTIKUJT E QERAMIKËS



Habibe Duraki është shembull i jashtëzakonshëm i femrës shqiptare, e cila ia ka dalë bindshëm dhe suksesshëm të integrohet e avancohet përtej kufijve shqiptarë, duke thyer mite e paragjykime për femrën shqiptare në Diasporë dhe atë në përgjithësi...

Pas shkollimit të mesëm në Drejtimin Matematikë e Latinisht, ka kryer Bachelor në Shkenca Sociale dhe, pastaj, ka vazhduar me magjistraturën në Kriminologji, në Universitetin e Lirë në Bruksel. Sidoqoftë, Habibe Duraki prej vitesh është pjesë e jetës publike dhe asaj politike në Bruksel.

Që nga viti 2012 është pjesë e Degës së Partisë Socialiste në komunën Evere të Brukselit.

Pas shumë angazhimesh, në vitin 2018, Partia e propozoi të ishte kandidate në zgjedhjet lokale. E mahnitshme, por reale, pas shumë përpjekjeve, takimeve pafund me qytetarë dhe punë të palodhshme, arriti të jetë gruaja më e votuar në komunën e saj.

Ajo është nënkryetare e komunës Evere, komunë kjo me mbi 41 mijë banorë.

Habibe Duraki është, pa dyshim, gruaja e parë dhe e vetme shqiptare në Belgjikë, me një post politik kaq të lartë.

**E para**  
**grua shqiptare**  
me post të lartë  
politik në Belgjikë



### **Kush është Habibe Duraki për ata që nuk e njohin?**

- Jam 35 vjeçe. Që nga vitet 90 jetoj në Belgjikë, konkretisht në kryeqytetin e Evropës, në Bruksel. Jam grua e implikuar dhe e angazhuar në jetën civile dhe politike belge që 10 vjet.

Jam e martuar, nënë e bekuar e tre fëmijëve të mrekullueshëm.

Ndjehem e plotësuar si në jetën private, ashtu edhe në atë profesionale.

Me profesion jam kriminologe dhe momentalisht jam nënkryetare në komunën në Bruksel.

Më karakterizon optimizmi, e dua jetën dhe mendoj se duhet të qëndrojmë të buzëqeshur, pavarësisht se çfarë na sjellë jeta.

Dashuria, solidariteti dhe respekti janë vlerat e mia primare që më përcjellin në çdo hap të jetës. Kudo dhe çdo herë që kam mundësinë e tregoj me shumë krenari që jam shqiptare dhe i promovoj vlerat e trojeve tona të bukura.

### **Si e kujton fëmijërinë, adoloshencën?**

- Një kohë shumë e bukur, me shoqëri besnike dhe jetë të thjeshtë, ku nuk na mungonte asgjë, me që prindërit kishin sakrifikuar çdo gjë për të na dhuruar jetë të mirë.

Isha vajzë perfeksioniste dhe nxënëse e mirë, e, në të njëjtën kohë, isha dhe ajo tek e cila të gjithë kërkonin këshilla dhe

mbrojtje.

Në shkollë isha ajo që e ngrehja zërin për të gjithë ata që përjetonin ndonjë padrejtësi, ose që nuk kishin guximin për të shprehur mendimin, pakënaqësinë, thjesht për të kërkuar të drejtat e tyre.

Në shkollë të mesme më thoshin "Habibe, je avokata jonë!".

Dhe, duke pasur prind që ishin gjithnjë dhe çdo herë të gatshëm t'i hapnin dyert e shtëpisë për të gjithë shqiptarët që kishin nevojë, jam rritur në një frymë të mikpritjes dhe gatishmërisë për të ndihmuar çdo njeri që ka nevojë.

E, një gjë e tillë vazhdon dhe vlen edhe sot e kësaj dite në shtëpinë tonë....

### **Kujtimi më i bukur i asaj kohe?**

- Pa hezitim, është momenti kur u kthyem për herë të parë në vendlindje, pas shumë vjetësh. Ishte emocion i madh. Në të njëjtën kohë ishte edhe e vështirë, sepse nuk i njihnim të gjithë familjarët...

### **A mund të flasim pak për shkollimin tuaj?**

- Mund të them me modesti se në shkollë kam qenë nxënëse shembullore dhe e motivuar për të arritur majat e dijes.

Pas mbarimit të shkollës fillore në Namur, familja ime u vendos në Bruksel dhe aty vazhdova shkollimin e mesëm



të përgjithshëm, në drejtimin matematikë dhe latinisht, duke e kryer me sukses. Pastaj, kam kryer bachelorin në shkencë sociale dhe juridike.

E, pasi arrita t'ia dal me sukses dhe pa e përsëritur asnjë vit gjatë gjithë shkollimit, e me dëshirën për t'u ngritur në aspektin intelektual, vazhdova me shumë bindje magjistraturën në ULB, e që është universiteti kryesor dhe më me nivel, por edhe më i njohuri ndërkombëtarisht në Bruksel.

Po ashtu, është e rëndësishme të cek se prindërit e mi kanë bërë çmos për ne, kanë sakrifikuar shumë. Çdo herë na thoshin: "Ju vetëm mësoni, për të tjerat kujdesi semi ne!".

Andaj, u jemi mirënjohës gjithmonë...

E, ndërkohë, paralelisht me shkollimin, kam përcjell edhe kurse për gjuhën holandeze, që është një ndër gjuhët zyrtare në Belgjikë.

### **Kur nisi aktivizimi juaj në politikë?**

- Nisi zyrtarisht në vitin 2012, edhe pse isha aktive edhe më herët në lëvizje të ndryshme.

Në atë vit u bëra zyrtarisht anëtare e degës së partisë sime në komunën time.

Dhe, hap pas hapi, e duke parë punën dhe seriozitetin tim në implikimin e të gjitha aktiviteteve dhe këshillave e takimeve të degës sonë, filluan të besonin në organizimin dhe përfshirjen time në shumë aspekte dhe shoqata të jetës komunale.

### **Sot, në çfarë pozita e poste e gjejmë Habibe Durakin?**

- Posti im kryesor është nënkryetare e komunës në të cilën jetoj. Jam ndër katër femrat nënkryetare në komunë dhe e para dhe e vetmja shqiptare nënkryetare në Belgjikë e më gjerë.

Jam e përfshirë në shumë këshilla udhëheqëse dhe administrata publike e politike, por nuk do i numëroja të gjitha, meqë lista është e gjatë.

Jam e angazhuar që shumë vjet në lëvizjen për të drejtat e barabarta dhe të grave, e cila organizon çdo manifestim rreth çështjeve të të drejtave të grave.

Jam në këshillin vendimmarrës të ngushtë të partisë sime për rajonin e Brukselit, si dhe në komunën time.

Jam kryetare e këshillit aktiv social dhe kulturor rajonal për tërë Brukselin.

Po ashtu, jam nënkryetare e qendrës kulturore po në atë komunë.

### **Sa të vë para përgjegjësi të mëdha posti që mban?**

- Posti nënkryetare nënkupton përgjegjësi civile dhe penale të mëdha.

Do të thotë, unë çdo ditë marrë vendime brenda kompetencave që më janë përcaktuar në fillim të marrjes së postit dhe ato vendime janë të llojllojshme, si, për shembull, funksionimi i një çerdheje ose përcaktimi i projekteve në lëmit tjerë që kam.

Vendimet e marra organizojnë funksionimin e një shërbimi, por dhe jetën e përditshme të komunës dhe qytetarëve të saj.

### **Si femër, si ndihesh për një arritje të tillë?**

- Është kënaqësi, por në të njëjtën kohë edhe përgjegjësi e madhe që e mbaj mbi supë.

Në të njëjtën kohë, arritja ime është dëshmia më e madhe që gjithçka është e mundur.

E, kjo sjellë motiv edhe për shumë femra...

### **Suksesi yt më i madhi deri më tash në karrierë?**

- Këtu ju jam tash, si gruaja shqip-

tare e para dhe e vetmja nënkryetare në tërë Belgjikën.

Por, edhe diploma ime në master në kriminologji.

### **Po, në jetë?**

- Natyrisht, familja zë vendin e parë.

Jam mirënjohëse për fatin që kam një familje të shëndosh, ku mbi-

zotëron dashuria e mirëkuptimi.

U kushtoj shumë rëndësi momenteve që ndaj me familje.

Jam e bekuar që i kam pranë...

### **Si e tregon më hapur dhe në mënyrë të dukshme origjinën tënde?**

- Në qershor të vitit 2019, për herë të parë vallëzohet vallja shqipe në komunën Evere, përballë komunës.

Të gjithë vallëzuan së bashku dhe u bashkëngjitën në valle;

Kërkova uljen në gjymëstizë të flamujve zyrtarë pas tërmetit e tragjedisë që ndodhi në Shqipëri, në shenjë solidariteti dhe mbështetje për Shqipërinë;

Në dhjetor të vitit 2019, në pazarin e festave të fundvitit, që e organizova në komunë si nënkryetare, inkorporova si temë edhe Shqipërinë dhe ushqimet tradicionale, vallëzimin dhe muzikën e mirëfilltë shqiptare. E, kjo u pëlqye shumë nga të gjithë banorët dhe shqiptarët prezentë, që banojnë në Bruksel;

Në shtator të vitit 2020 kam blerë një pikturë të Nënës Terezë, të cilën e kam vendosur në zyrën time në komunë.

E, këto janë vetëm disa nga gjërat që kam bërë, e që tregojnë se me aq sa mundem bëj për promovimin e vendit dhe kulturës tonë shqiptare.

### **Suksese të mëtejme!**

- Ju faleminderit për bisedë!

**Nderim Neziri**



## Po iku KFOR-i, unë para tyre!

*Jeta vazhdon me realitetin e saj të larmishëm. Përditë ka ndodhi, fjalë, llafe... Përditë ka muhabet, kudo që gjendemi: në rrugë, në kafene, në ndeja...*

*Dhe, teksa pimë kafenë e mesditës, secili flet nga këndi i vet për përditshmërinë tonë, veçmas për politikë. Temë e nxehtë këto ditë është asociacioni...*

### PSE TË FLIJOHEMI ENDE PËR KOSOVËN?!

"Pas përfundimit të luftës menduam se u çliruam njëherë e përgjithmonë nga Serbia, por e kishim pasur keq!", thotë Dema, i cili rrallë herë flet kur jemi në shoqëri

bashkë, sepse mundohet të mos e mbajë mendjen te politika dhe vazhdon:

"E, kur u shpallë Kosova shtet i pavarur, jo vetëm që festuam, por edhe atëherë menduam se më Serbia s'mund t'ia bëjë kërke Kosovës!

Por, edhe këtë herë kishim pas menduar jo mirë, sepse nisi dialogu, kinse për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës e Serbisë, e Serbia nisi t'i qet brirët si çdo herë.

Së pari, nisi me kërkesën për asociacionin, pastaj deshi të bëjë aneksimin e veriut më 24 shtator me sulmin terrorist në Banjskë të Zveçanit!"

"Hej, bre Demë, po mirë i paske regjistruar ngjarjet e pasluftës?!", ndërhyjnë në muhabet Sokoli, gazetar shumëvjeçarë dhe vazhdon:

"Po, lena edhe neve të flasim pak, se i pimë kafetë t'u fol vetëm ti!"

"Fol-fol, sa të duash!", ndërhyjnë Dema.

"A nuk është si po them unë, a?! Jepi argumentet kundër! Jep n'paç çka me dhënë! A po e sheh se na rrou dreqi?! Më për Lugjinën e Preshevës nuk po flet kush?! Bile, ta kishim marrë Preshevën e Bujanovcin, si shkëmbim, kishim fituar diçka..."

Por, edhe pa to mbetëm!"

"Allahile, çka t'u ka hapur goja, se na i le kafetë në fyt!", i thotë Sokoli, sepse i vjen inati se krejt çka tha Dema i kishte me vend...

### BASHKË ME KFOR-in EDHE UNË!

"Ndoshta nuk di shumë, por një gjë di: Me bë me shkuar KFOR-i, unë kam me u nisur për në Shqipëri para tyre, se beli më nuk e pres luftën në Kosovë, siç bëra më 1999, ku isha sa në Mramor, sa në Hajvali, sa në Kolovicë, e sa mezi dola kah fundi i luftës në Maqedoni", thotë shumë i nervozuar Dema, e që sapo kishte ardhur nga Gjermania, ku kishte qenë për pak ditë te vajza e tij, e martuar me një gjerman.

"Besa, edhe unë mendoj ashtu!", thotë Sokoli dhe vazhdon: "Kush është ai i krisur që e pret më luftën në Kosovë?!"

"O, ndalni burra, e mos merrni turr, se sa të është Amerika këtu, më nuk ka luftë në Kosovë! Por, t'i pimë kafetë rahat!", u them unë, më shumë për ta përmbyllur këtë muhabet, që, si duket, s'i shihet kund fundi..."

Isa ILAZI

# DISA VDESIN SIKUR S'KANË JETUAR KURRË!



S'di a e keni edhe ju këtë përshtypje se shpejt po ikin ditët?  
Ndoshta pak vetëve u duket kështu apo edhe shumicës, por, pa dyshim, ka edhe të atillë të cilëve u duket se ditët po ecin ngadalë.  
Ata janë në pritje të një diçkaje, janë të dëshpëruar, pa vullnet...  
I kësaj kategorie të njerëzve është edhe një mik imi, i cili më thotë se e ka marrë malli për ditë të mira, ku problemet janë larg.  
E, nga kjo del se nuk është e vërtetë se njeriu ndryshon me kohën. Ai ndryshon me zhgënjimet që merr nga jeta.  
Siç thonë, njerëzit gati gjithmonë mendojnë mbrapsht: Humbin shëndetin duke vrapuar pas parasë dhe, pastaj, i humbin paratë për ta rikthyer shëndetin!  
Mendojnë me ankth të ardhmen dhe lënë pas dore të tashmen. Si përfundim, jetojnë sikur kurrë nuk do të vdesin dhe vdesin sikur nuk kanë jetuar kurrë.

\*  
Secili e ka jetën e vet: të mirë a të keqe, të varfër a të begatshme, të dhembshme a të lumtur...  
Secili e ka tregimin e vet të jetës.

Secili i ka përjetimet e veta.  
Askush s'mund ta njehë shpirtin a zemrën tënde më shumë se që e njeh ti vetë.  
Kishte thënë njëri: Që ta gjykosh jetën a karakterin tim mbathi këpucët e mia dhe ec, kalo rrugën që kalova unë!  
Jetoje skamjen time!  
Përjetoje lotin tim!  
Jeto vitet që jetova unë!  
Rrëzohu ku rashë unë!

\*  
Nëse nuk e keni ditur: mjellmat gjatë tërë jetës e kanë vetëm një partner. E nëse partneri i tyre ngordh, nga thyerja e zemrës, ngordh edhe tjetri.  
Me një fjalë, sa të jetojnë - jetojnë bashkë. Kur ngordhin - ngordhin bashkë.  
E, pabesueshme, a?!

## E POPULLIT...

I pasuri beson në para,  
i dituri në shkencë,  
i varfëri në Zot!

Gani Dili

# KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**  
Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**  
Isa ILAZI

**Menaxher:**  
Driton DILI

**Redaksia:**  
Safet Krivaça (reporter i lirë)  
Nderim Neziri (redaktor)  
Besiana Dili  
Drenushë Haredinaj  
Ardita Dili  
Edona Vllasaliu - Bajoku  
Xheneta Spahiu

**Dizajni:**  
Labinot Bërbotovci

**Adresa e redaksisë:**  
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë  
**Tel:** 038 51 75 75  
**Email:** [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**  
Tel: +383 44 143 448;  
**Email:** [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)



## *Ideatori i Deklaratës Kushtetuese* **“Kosova Republikë”**

*Akademik Gazmend Zajmi u lind në rrethin e Krumës së Hasit, në Shqipërinë verilindore.*

Shkollimin e bëri në Prizren. Studio drejtësi dhe shkenca politike në Universitetin e Beogradit, ku kreu magjistraturën në vitin 1973. Pas studimeve punoi gjyqtar në Prizren dhe ligjëroi në Fakultetin e

Drejtësisë të Universitetit të Prishtinës. Në kohën e demonstratave të vitit 1981 ishte rektor i Universitetit të Prishtinës dhe për 10 vjet u dëbua prej tij nga autoritetet serbe. Akademik Gazmend Zajmi ishte anëtar i Komitetit të Përhershëm të Konferencës së Rektorëve Evropianë, i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve (në Salzburg dhe Vjenë). Punoi profesor i “Teorisë politike” dhe i të “Drejtës kushtetuese” në Universitetin e Prishtinës. Ishte shef i Katedrës së Shkencave

Shoqërore-Politike dhe i shumë funksioneve të tjera. Por, si kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, kishte arritur të hartonte Deklaratën Kushtetuese për shpalljen e “Kosovës Republikë”, pas suprimimit të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, deklaratë të cilën unanimisht e përkrahën delegatët e atëhershëm shqiptarë të Kuvendit të Kosovës, të cilët edhe e shpallën Kosovën Republikë. Vdiq më 10 mars 1995.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
AKADEMIJA NAUKA I UMETNOSTI KOSOVËS  
KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

# Politizimi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Ditën e premte, datë 10 nëntor 2023, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës kishte organizuar tryezën shkencore "Ndotja e mjedisit nga materialet plastike dhe substancat organike rezistente dhe metodat e trajtimit".

Dhe, me të dëgjuar këtë lajm në emisionet e lajmeve në televizionet tona, e që i kushtuan goxha hapësirë, deshe a s'deshe, mendja më shkoi se Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës është politizuar, sepse vetëm pak ditë më parë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bëri një shëtitje nëpër disa markete të mëdha, kinse për t'u njohur më së afërmi se a po përfillen apo jo qeset plastike, të cilat janë ndaluar me ligj, në vend se atë ta bëjnë inspektorët, të cilën edhe mar-

rin pagë për një punë të tillë. Por, t'i kthehem qëllimit të këtij shkrimi. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës ka shumë vjet që ka rënë në gjumë dhe nuk ndihet gjallë për problemet e shumta me të cilat ballafaqohet Kosova, në radhë të parë në aspektin politik, e që temë e nxehtë qe dhjetë vjet është kërkesa për themelimin e Asociacionit. Akademia asnjëherë deri më tash nuk doli me një kumtesë për këtë çështje, e të mos flasim për problemet e tjera, e që janë me bollëk në Kosovë, si, bie fjala, papunësia, gjendja e rëndë ekonomike e popullit të Kosovës, gjendja e rëndë e pensionistëve të Kosovës, ikja e të rinjve jashtë Kosovës, ikja e kuadrit më të mirë dhe më të kualifikuar jashtë Kosovës.

Dhe, çka jo tjetër?!

E, për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, siç shihet, Kosova s'paska problem më të madh se qeset plastike!

Dhe, të kujtojmë se më 1990, pak ditë para miratimit të Deklaratës Kushtetuese për Kosovën-Republikë, e cila deklarata u pranua unanimisht nga delegatët e Kuvendit të Kosovës më 2 korrik 1990, Akademia e atëhershme e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës i parapriu këtij vendimi shumë të veçantë në jetën politike të Kosovës.

E, pse tash, bie fjala, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës të mos dalë me komunikatë për formimin e Asociacionit?!

**Selim Rama, Prishtinë**

# Si ta bindi burrin se nuk po e tradhtoj?

Jam grua me shumë halle, probleme.

I kam dy fëmijë.

Burri ka kohë që dyshon se po e tradhtoj!

E, në fakt, nuk është e vërtetë, sepse askënd nuk e dua pos burrit. Ju lutem, Redaksi e nderuar, kam nevojë për këshillë...

**Viola, Ferizaj**

Besojmë se ai nuk dyshon në ty, por e ka të zhvilluar psikologjinë e intrigës, e që, duke të akuzuar ty, e

mbulon veten!

Në këtë mënyrë, ai nuk të jep aspak kohë të merresh me të, sepse është në ofensivë të përhershme ndaj teje!

Dhe, duke të akuzuar ty, ai e përshtat veten në hap me nevojat dhe sjelljen e tij, në mënyrë që të mos e kapësh në vepër.

Kështu, pra, je lodhur duke iu përgjigjur çdo ditë se nuk e ke askënd, ndërsa ai del nga shtëpia në drejtim të dëshirës së vet, duke të lënë të akuzuar dhe të

nervozuar nga sjellja e tij, por edhe me shumë pikëpyetje se çka do të ndodhë në të ardhmen me ty...

Pra, nëse të akuzon përsëri, thuaj: Jepi faktet që po të tradhtoj! E, vetëm në këtë mënyrë ke mundësi të shpëtosh prej tij...

Përndryshe, po të ishte e vërtetë se ke tjetër, të largon nga shtëpia pa një e pa dy, sepse mendjen e mbanë vetëm te tradhtia...

Andaj, meqë je e pastër, mos ia ke frikën!





# MENAKON

CREATIONS



[www.menakoncreations.com](http://www.menakoncreations.com)

+38649261212 +38344132343 📍 Dardania I, St 6, Gjilan

 /menakon.creations





# Pse minatorët e “Trepçës” si bën kush hesap?!

*Miniera e “Trepçës”, edhe pse punon, ka probleme të ndryshme. Minatorët që punojnë në të ankohen se kushtet në punë i kanë të vështira, pagat të vogla e jo të rregullta... Madje, pakënaqësitë i kanë shprehur edhe me grevë, duke u ngujuar qe 10 ditë në të!*

Rruga rreth gjigantit “Trepça”, në Stan Tërg, gjallëron me automjete, që vijnë e shkojnë nga fshatrat e Shalës së Bajgorës kodrave të larta.

Rreth rrugës kryesore për në Shalë të Bajgorës, rrugë e cila e lidhë Mitrovicën me Podujevën, malësorët kanë zgatur rendet e druve të prera për shitje, ndërkohë që gjethet e drunjve përreth rrugës përpjetë kanë marrë ngjyrat e vjeshtës: të kuqe e të verdha vende-vende, e aty-këtu edhe nga pak ngjyrë e gjelbër.

Banorët e Shalës së Bajgorës thonë se po të kishin qenë rrugët e mirëmbajtura për

lëvizje të popullatës dhe po të ketë kushte për jetesë në këtë anë, banorët nuk do e kishin braktisur rajonin e Shalës, e që dikur ishte shumë i populluar, sepse në këtë pjesë ka bazë për jetesë, madje edhe me ajër shumë të pastër.

Se fshatrat e Shalës së Bajgorës dikur kanë pasur një zhvillim të hovshëm, tregon edhe lashtësia e xhamisë së Mazhiqit.

“Kjo xhami është këtu prej kur mbaj mend unë”, thotë bashkëbiseduesi, Ejupi, burrë rreth të shtatëdhjetave, teksa kalojmë pranë kësaj xhamie.

## BAJGORASIT E KANË MBIPOPULLUAR MITROVICËN

Shumica e popullatës së Mitrovicës është nga viset e Shalës së Bajgorës.

Sidoqoftë, në Shalë të Bajgorës ende ka shumë fshatra me banorë të përhershëm. Jo me aq banorë sa kishte dikur, por ato janë të banueshme dhe në to ndihet gjallëri, si në Trepçë, Mazhiq, Pasomë, Tërstenë, Rashë, Bare, Vidishiq, Zabërgjë, Bajgorë, Melenicë, Kovaçicë, Magjevë, Dedi, Vllahi, Kaçanoll dhe Selac.

Megjithatë, në kohën e ish-Jugosllavisë këto fshatra kanë qenë me shumë banorë dhe është zhvilluar një jetë shumë dinamike. Ka pasur kushte të mira jetësore,

sepse shumica e banorëve kanë punuar në Kombinatin “Trepça”.

Por, në kohën e masave të dhunshme të Serbisë, konkretisht me dëbimin e punëtorëve nga “Trepça”, shumica e popullatës është larguar nga ky rajon, duke migruar për kushte sociale në Mitrovicë, Vushtrri e gjetiu, e veçmas në shtetet Skandinave. E, kur them se dikur ka pasur kushte më të mira, kam parasysh se këtu ka funksionuar edhe një fabrikë për përpunim e lëndëve lëkurore, si dhe ka pasur kushte më të favorshme për bagëti.

E, në kohën e luftës, më 1999, lufta dogji e i shkatërroi në masë të madhe të gjitha shtëpitë e popullata u largua nga ky rajon. Problem tjetër paraqesin dimrat, në veçanti në fshatin Bajgorë. Bora fillon edhe atëherë kur fshatarët nuk e presin fare dhe e vështirëson jetën këndeje pari.

## GREVA E MINATORËVE

E, t’i kthemi edhe një herë gjigantit “Trepça”, punëtorët e të cilit ndodhen në grevë, meqë janë të pakënaqur me kushtet e punës, pagat e vogla...

Por, e keqja më e madhe, sipas tyre, është injorimi që u bëhet nga organet shtetërore, të cilët, as në ditën e dhjetë të grevës, kur po e shkruaj këtë shkrim, nuk i vizitoi askush!

S. Krivaça

# Ç'muhabete bëhen në konviktin e vajzave?

*Një nate të vonë, në konviktin e vajzave, teksa ndodhesha te një tezake imja, flitej e përflitej për një profën me rrudhat në ballë, i cili tarahitet poshtë e lart me vajza të reja...*

Ato e gjykojnë profën dhe shfaqin gjithfarë dilemash. Por, në anën tjetër, nuk lënë pa i kritikuar edhe vajzat e reja që dalin me njerëz të tillë si profa. Madje, thonë se çiftet e tyre ua marrin grave edhe burrat!

Profa me ballin rrudha-rrudha ishte i martuar. Bile, shpesh e shihnin në kafene me gruan e tij.

Dhe, çka me pa: Gruaja e tij flokët si shtrigë, sytë e mëdhenj, qerpikët e gjatë, veshjen si Kasandra!

Por, ndoshta e keni harruar Kasandrën?!

Ajo, para lufte, luante në një film spanjoll. Veshja e saj shumëngjyrëshe ishte karakteristika e saj kryesore.

E, për profën flitej se në rininë e tij ka

qenë shumë i bukur...

"Po, ndoshta ka qenë i bukur, por tash është plakur dhe nuk i ka hije të tarahitet me vajza të reja në kafene! Ndoshta as ato nuk e donë, por mashtrohen për një gjashtëshe dhe, pastaj...," thotë tezakja ime.

## FILANIA DEL ME FILANIN...

Dhe, sillen e pështillen, nuk flasin për tema të tjera, për përditshmëri, për kushtet në konvikte, për orët e gjata të udhëtimit të premtëve kur shkojnë në shtëpitë e tyre për vikend, e tema të tjera që ka sa të duash, por vetëm për atë se filania del me

filanin, filania shkoi për konsultime në kabinet me profën, e të tjera të ngjashme...

"Nejse de, secili i di punët e veta. Por, mendoj, më mirë kështu si ne!", ndërhyrën në muhabet Betja, nga Rahoveci dhe vazhdon:

"Fytyra nuk është një hektar! Se, çka të duhet jeta kur kryet s'mund ta qosh nga fjalët, nga thashethemet! Por, edhe ato herë do kur bijën në hundëlesh!"

Dhe, me këtë përmbyllje të Betjes, sikur rrumbullakësohet muhabeti, e mua më jepet rasti të ngrihem, sepse nesër më pret shkrimi që ta dorëzojë në Redaksi.

**Diturie Haxhaj**

# Në dynjanë tjetër është një livadh me lule...

*E lëshoj televizorin.  
Qëllon koha e lajmeve.  
Njësia policore më elitarë e Kosovës Fit në protestë. Dhe, deshe a s'deshe mendja më rikthehet te e kaluara politike...*

Nëse do të ishte Albin Kuti në opozitë, ai do u ishte bashkëngjitur njësitit policor në protestë, duke i përkrahur pa rezervë, duke vajtuar për ta, e, mbi të gjitha, nuk besoj se nuk do t'i vandalizonte xhamat e Qeverisë me gurë e kubëza!  
Po të ishte Kurti në opozitë, minatorët e "Trepçës", të paktën, do i përkrahte, duke u premtuar se kur të vjen në pushtet, ata do t'i kenë të gjitha të mirat në xhep, në shtëpi e familje!

Dhe, teksa i kujtoj këto gjëra, më kujtohet si fliste në përkrahje të mjekëve, pensionistëve, bashkimit kombëtar...  
E, s'kishe çka thua tjetër, pos: Zoti ia ofroftë sa më parë Kurtit postin e të parë të qeverisë!

Po, ne jse, kjo ma kujtoi një ligjëratë të imamit të xhamisë së një fshati të rrethit të Ferizajt, ku ndodhesha edhe unë (emrin nuk po ia përmendi se tashmë është i ndjerë).

Ai xhematit u fliste për parajsën...  
"Në parajsë është një livadh i madh, sa nuk ta mbërrijnë sytë me pa fundin... Livadhi është i mbushur me lule. Rreth tij kalon një lum, i cili në vend të ujit ka tambël.

Anash lumit janë pemët më të shijshme që ka ndokund: banane, hurma, fik, portokaj dhe çdo lloj tjetër peme që e do goja e njeriut...

Atje, në atë livadh, janë do lule që në livadhet tona nuk i keni parë. Janë si lulet tona me shumë ngjyra në

livadhe, por ato lëshojnë erë më të mirë se lulet që i kemi ne..."

Dhe, teksa bënte përshkrimin e parajsës, esenca e atij ligjërimi m'i kujton premtimet e Albin Kurtit në fushatat zgjedhore, që ua adresonte popullit shqiptar të Kosovës...

## KUSH KUNDËR KUJT DO PROTESTOJË?!

U dha lajmi se do të protestohet edhe për zbardhjen e fatit të Astrit Deharit. Anëtarët e VV-së do bëkan protestë. Por, s'e kam të qartë se kush kundër kujt do të protestojë?!

E, nëse ata protestues që do të dalin (nëse dalin), do të kërkojnë zbardhjen e rastit të Deharit, kush do të merret me zbardhjen e rastit të tij, kur dihet se ata që do të protestojnë vetë janë në qeveri?!

Pra, kush kundër kujt do të protestojë?!

**Sokol Murturi**





**BREZOVICA**  
HOTEL & SPA



*Takimet dhe Eventet*



Për rezervime:  
+383 49 30 10 30 | +383 45 60 70 70  
[sales@brezovicahotel.com](mailto:sales@brezovicahotel.com)

# Ndërtuan 280 shtëpi, 280 lumturi!

*Organizimi për formimin e Shoqatës Humanitare “Feniks” nga Ferizaj u bë në vitin 2007, nga gjashtë individë, e që ishin figura të njohura në Ferizaj me rrethinë: Milaim Jashari, Sadik Sadiku, Sevdije Frangu, Ali Lipovica, Prof. Ramadan Jakupaj dhe Arsim Jakupaj.*

*Por, pse e ndali aktivitetin e saj Shoqata Humanitare “Feniks” nga Ferizaj, e cila i ndërtoi 280 shtëpi për skamnorët dhe familjet e dëshmorëve e invalidëve të luftës së UÇK-së?*

Të shtunën që i bëmë Ferizajt, më 11 nëntor 2023, në Qendrën Tregtare “Eli ab”, ish-kryetari i Shoqatës Humanitare “Feniks”, rikujtoi me nostalgji punën e ndërtimit të shtëpive për shtresën me nevoja për kulme familjare në etapën paslufte, kur njerëzit kishin humbur shtëpitë, kishin mbetur invalidë lufte, e të tjera të ngjashme. Dhe, rreth atyre zhvillimeve, ish-kryetari, Milaim Jashari, thotë: “Fillimisht kemi nisur punën jo si shoqatë, por vetëm nga këndvështrimi humanitar. E kemi pasur një rast fshatin Greme,



Milaim Jashari

kur familja e Shaban Qelit, e që ia kishin djegur shtëpinë në luftë, jetonte në koshin e misrit! Dhe, në bisedë e sipër me veteranët e luftës së UÇK-së, teksa bisedoja me stomatologun e njohur në Ferizaj, Ekrem Selmanin, me iniciativën e tij u nisëm ta vizitonim atë familje. Doktorin, aty për aty, asaj familje ia dha 11 mijë euro për ndërtimin e shtëpisë. Tutje, ai kontribuoi në ndërtimin e tri shtëpive të para që janë ndërtuar ende pa u themeluar Shoqata Humanitare “Feniks”.

## IDEJA PËR FORMIMIN E SHOQATËS...

“Pas ndërtimit të tri shtëpive të para, u përhapë lajmi se për skamnorët po bëhet diçka...”

Por, nevojat ishin shumë të mëdha dhe urgjente, sepse njerëzit kishin humbur gjithçka, ndërsa shteti nuk kishte fuqi t’u dilte në ndihmë”, thotë Milaimi dhe vazhdon:

“Andaj, në mbështetje të disa veprimtarëve, themeluam Shoqatën “Feniks”, emër të cilin e pagëzoi Sadik Sadiku.



Shoqatën e përbënin 6 anëtarë. Kryetar më zgjodhën mua. Qëllimi ynë, në radhë të parë, ishte t'i ndihmonim veteranët dhe invalidët e UÇK-së, por regjistrimi zyrtar nuk mund të bëhej pa i përfshirë edhe rastet skamnore në Kosovë dhe jashtë saj, duke përfshirë edhe të burgosurit politikë.

Fillimisht, shoqata është mbështetur në inkasimin e mjeteve në mënyrën më të thjeshtë, duke kërkuar nga një e dy euro nga punonjësit e arsimit, të shëndetësisë dhe policisë.

Dhe, tre vjet kemi punuar me këtë lloj inkasimi... Më së shumti shtëpi me para të veta i ka ndërtuar Basri Sopi, nga "Eli Ab" - 49 shtëpi.

Basri Sopi ka thënë se babai ia ka lënë amanet humanitetin dhe ai e renditi këtë kontribut që do ta bënte si një zekat për nevojtarët".

## KUSH ËSHTË, MË KONKRETISHT, MILAIM JASHARI?

"Kam qenë i burgosur politik në vitin 1981. I dënuar me shtatë vjet burg, prej të cilave katër vjet i kam mbajtur. Kam qenë i burgosur nga izolimi në vitin 1989, duke mbajtur burg në Vranjë dhe në Shabac të Serbisë, në grupin e intelektualëve që nënshkruan letrën e njohur të kohës.

Kam qenë me tërë familjen në luftë, i plagosur në luftë në Jezerc. Pas shërimit jam kthyer përsëri në luftë, po aty".

## KUSH JANË VEPRIMTARËT TJERË?

"Veprimtars Servdije Frangu, nga Kaçaniku, ia kishin vlarë babanë se nuk e kishte hequr plisin nga koka.

Edhe burrin ia kishin vlarë serbët, kurse vajza e saj ra dëshmore në luftën e UÇK-së.

Por, edhe vetë ishte e plagosur dhe ka ndërruar jetë dy ditë para se të ndërronte jetë Adem Demaçi.

Me profesion ka qenë ekonomiste dhe ka mbajtur shënime për shpenzimet. Çdo gjë që kemi punuar e kemi evidencuar në ditarin e shënimeve: Me shifra e fotografi, me fatura dhe përrime. Në shumë prej atyre shtëpive që i kemi promovuar ka marrë pjesë



Shaban Qeli Fsh.Greme - Ferizaj, veteran i UÇK-së, ndërtimi: 24.12.2005

Donator: Dr. Ekrem Selmani EXSTRADENT - Ferizaj

Adem Demaçi, me të cilin kemi qenë së bashku në veprimtari patriotike", thotë Milaimi.

## PSE U NDËRPRE PUNA E SHOQATËS?

Në vllugun e punës së ndërtimit të shtëpive për skamnorët, shoqata e ndali punën.

Rreth kësaj ngjarjeje, ish-kryetari, thotë:

"U vjetruam. Disa anëtarë ishim me

sëmundje. Disa shkuan jashtë. Sevdija vdiq. Vetë nuk isha mirë me shëndet. Andaj, në aso rrethanash, nuk mundëm ta qojmë më tej funksionin e shoqatës..."

Dhe, në fund të bisedës, shton: "Sidoqoftë, për ne, që kemi kontribuar falas, përkundër faktit se punë kishte shumë, gëzim më të madh dhe kompensim më të madh se kur e gëzon një familje me shtëpi te re nuk ka", thotë Milaim Jashari.

**Safet Krivaça**



# Pse e fshehim dhimbjen?!



*Dhimbje tepër e rëndë është atëherë kur plagën emocionale nuk mund ta tregosh e as ta shpjegosh. Dhimbje që zemrën ta copëton e shpirti të rënkon. Dhimbje që as loti nuk e zvogëlon e as koha nuk e shëron...*

Ne heshtim, duke besuar se ka ngjarje që nuk duhet treguar askujt dhe vazhdojmë me gënjeshtër tonë të preferuar "Mirë jam dhe çdo gjë është në rregull".

Të gjithë e besojnë dhe nuk kemi nevojë askujt asgjë t'i shpjegojmë. Ndonjëherë heshtja është klithma më e fortë që njeriu mund ta nxjerrë, sepse kur "Shpirti qanë, lotët nuk shihen".

## PSE E MASHTROJMË VETEN?!

Dhe, ne, e gjitha që bëjmë për ta tejkaluar këtë dhimbje, vazhdojmë ta dehim frikën dhe ankthin tonë me substanca kimike, të cilat më shumë na dëmtojnë se na shërojnë, përforcojmë ambalazhin tonë të jashtëm, duke e ushqyer egon tonë me gjëra materiale dhe vazhdojmë të mashtrojmë veten se edhe këtë herë ia dola... Nuk duhet të harrojmë se të gjitha traumat e "fshehura" dhe të papërpunuara, bëhen helmuese për trupin dhe mendjen tonë. Herët apo vonë, trauma që nuk shërohet në kohë, është më e keqe se heshtja dhe krenaria jonë, sepse përderisa na duket se në një periudhë na mbrojnë, në të vërtetë, ato veç edhe më shumë shpirtin na demaskojnë!



**PRAXIS FÜR  
PSYCHOLOGISCHE  
BERATUNG**  
Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de  
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6  
56422 Wirges



Dhe, ta kemi parasysh se askush nuk ka të drejtë të na lëndojë, askush, madje as krenaria jonë e tepërt.

## KËSHILLË...

Kujdesuni për veten tuaj dhe merrni guximin të rrëfehëni, sepse problemet zgjidhen duke folur, e jo duke ndaluar së foluri me heshtjen që dikur vret!

**Shkëndije Pacolli**


# BOOM

## Rrap Kryeziu, bukuroshi kosovar, imazh i brendit të famshëm për orë dhe syze “Enzo Attini”

*Gjuha e urrejtjes  
në mediet sociale  
ndaj banoreve femra  
në “Big Brother VIP”*

*Ku është dallimi ndërmjet  
“Big Brother Kosova”  
dhe “Big Brother Albania”?*





# Rrap Kryeziu, bukuroshi kosovar, imazh i brendit të famshëm për orë dhe syze “Enzo Attini”

*Të gjithë e njohin brendin e famshëm për orë dhe syze, “Enzo Attini”, që nuk mund të shpërfilllet për shkak të cilësisë, dizajnit dhe të qenit shumë IN edhe mes personave të famshëm e me influencë.*




## “ENZO ATTINI” - CILËSI, ELEGANCË, STIL E INOVACION

“Enzo Attini” përfaqëson elegancën, stilin dhe inovacionin në industrinë e luksit dhe modës pa bërë kompromis me cilësinë. Orët e firmës “Enzo Attini” kanë mekanizëm zviceran dhe vijnë me pesë deri në njëzet e gjashtë gurë rubini.

Transporti i tyre deri te ju është i shpejtë dhe bëhet në të gjithë botën.

Bashkë me orën e blerë, klientët përfitojnë plus 25 euro kartë dhuratë, larje me flori 18k, gdhendje artisanale 3d me dorë në pjesën e pasme të orës, rrip dhuratë me vlerë 50 euro, rrip lëkurë italiane, xham zafiri me shtresë antirefleksim, një certifikatë autenticiteti, copë pastrimi me microfibre dhe, pa dyshim, paketimin premium. Ora “Enzo Attini” ka garanci 2 vjet, nga data e blerjes.



## SYZET E BRENDIT “ENZO ATTINI” - TË PARAT NË CILËSI DHE DIZAJN

ADN-ja e syzeve “Enzo Attini” janë dizajni italian dhe materialet më të mira në botë në industrinë e syzeve, si: titani, bio acetati, nanjoni organik dhe inoksi 316L. Xhamat ofrojnë qartësi optike të jashtëzakonshme, polarizim të përsosur dhe dizajn të sofistikuar, duke krijuar një kombinim të përkryer midis stilit dhe performancës.

## RRAP KRYEZIU, BUKUROSHI NGA KOSOVA, IMAZH I BRENDIT “ENZO ATTINI”

“Enzo Attini” është brendi më i njohur dhe më i sigurt në sektorin e shitjes online dhe ju mund t’i keni aksesorët e jashtëzakonshëm pa lëvizur nga vendi. Ka kohë që një nga imazhet e këtij brendi të famshëm është bërë edhe Rrap Kryeziu, i cili kishte një eksperiencë televizive si prezantues, për çka u pëlqye mjaft.

**N. Neziri**

**Foto: Armand Sallabanda**



# Ku është dallimi ndërmjet “Big Brother Kosova” dhe “Big Brother Albania”?

**Gjeje shokun më të mirë se veten! Efi del kundër Kiarës: I erdhi inat se humbi lojën**

*Që nga 1 vitet, Efi ndërron lojtarin më të fortë në shtet*



Të dy formatet me qëllime, lojë dhe strategji të njëjta po vijnë një herë në vit në ekranet tona. Por, ka një dallim shumë të madh ndërmjet tyre, e që dita-ditës po bëhet më i qartë. Fuqizimi i gruas është temë aktuale, e që po mbështetet më shumë se kurrë. Sepse, duke kujtuar se çfarë iu bë Beatrix Ramosajt, Efit dhe Kiarës në Kosovë, duket se është më ndryshe mbështetja, si nga produksioni ashtu edhe nga i gjithë stafi, se nuk po i lë vajzat të ndihen asnjëherë keq. Rasti i fundit me mesazhet nga jashtë për Vesën, na i kujton mesazhet që mori si “avantazh” Kiara.

Për Vesën ishin zgjedhur lajmet nga portalet që e bënin atë të flasë të vërtetën, kurse për Kiarën ishin zgjedhur lajmet jo të mira, që i humbën orientimin në lojë brenda shtëpisë. Prandaj, dallimi është i madh ndërmjet këtyre dy spektakleve “Big Brother”.

**Edona Vllasaliu-Bajoku**

**Kiara i paska lënë një 'shije të keqe' Ermionës: Ti dhe Olta jeni e njëta kategori**

*Ermiona i shkëlqoi ka reaguar shpesh pas përjashtimit të saj nga "Big Brother vip" mëngjesit e sotëm. Ish-miss i tre vitet të një postimi beiter në Instagram, ka falënderuar të gjithë ata që ia bëjnë më të bukur dhe të shprehin qendrimin e saj në shtëpi*



**Motra e Olta Gixharit rëndit 'një më një' arsyet pse lidhja Kiara-Luiz nuk do të funksiononte jashtë shtëpisë së Big Brother VIP Albania**

**S** SHIKOJA NJA NOTICEN  
E SHIKOJA 2023



**Gossip**





# Gjuha e urrejtjes në mediet sociale ndaj banoreve femra në "Big Brother VIP"

"Big Brother VIP" është reality shou, që organizohet në mbarë botën dhe ka rrëmbyer zemrat e publikut.

Arsyeja që shikohen shumë këto spektakle, janë se në to ka karaktere të ndryshëm, e publiku sikur e gjen veten.

Edhe në Kosovë e Shqipëri po zhvillohen këto ngjarje dhe kanë thyer çdo rekord shikueshmërie. Por, në Shqipëri komentuesit janë shumë të ashpër ndaj banoreve femra dhe në një farë forme kanë degraduar.

## PSE URREHEN FEMRAT PJESËMARRËSE?

Në vazhdim përmendim disa banore që kanë qenë raste të rënda nga kjo temë...

Të kujtojmë Beatrix Ramosajn, e cila krijoi një lidhje dashurie me

aktorin Donald Veshaj. Kjo edhe ishte arsyeja që mori urrejtje massive.

Në edicionin e dytë të spektaklit ishte vetëm një banor i preferuar dhe femrat që fituan urrejtje ishte shkaku se si ato vepronin në raport me të.

Olta Gixharri ishte kundërshtarja më e fortë e tij, kurse Kiara Tito, që krijoi lidhje brenda spektaklit, nuk e përjetoi edhe aq lehtë dhe një gjë e tillë ndikoi rëndë në gjendjen e saj emocionale.

Ndërkaq, në spektaklet "Big Brother VIP Kosova" audienca dhe komentet dinë të jenë të larmishme. Pëlqyeshmëria dhe jopëlqyshmëria e publikut ndaj banoreve varet, kryesisht, nga situatat që ata krijojnë brenda në shtëpi.

Por, veprimet e femrave nga audienca gjithmonë shihen me llup, andaj, në këtë edicion, ka dinamika

të shumta mes femrave për dallim nga edicioni i kaluar.

Këngëtarja Lindita Halimi është banore, e cila iu bashkua këtij reality shou, por publiku ka shpërryer me komente tejet negative ndaj saj.

Banore tjetër e kësaj kategorie është Albana Vukaj, e cila, me bukurinë e saj, ka rrëmbyer zemrat e disa meshkujve brenda, por kjo ka bërë që të mos pëlqehet në publik. Andaj, komentet dhe urrejtja masive për të filloi kur ajo nisi të tregohet reale dhe në paqe me veten.

Nga entuziazmi i audiencës, për të parë storie dashurie në shtëpi, bën që Albën të mos e duan më, meqë tregoi se nuk kishte ardhur për të krijuar romancë.

E, çka do të ndodhë tutje, mbetët të shihet?

**Xheneta Spahiu**



# Mrika Krasniqi, femra e shumë shpërblimeve

*Mrika Krasniqi është producente, skenariste dhe regjisore e njohur e filmit.*



Ajo e ka një kompani të krijuar vetë, me titull "Nil Corporate", në Kosovë dhe në SHBA. Gjithashtu, bashkëpunon me kompani të ndryshme amerikane e evropiane. Në vitin 2012 e ka themeluar Festivalin "Java e Filmit Shqiptar" në Amerikë. Arti është pasioni dhe profesioni i Mrikës, që e ka kultivuar me shumë vullnet e këmbëngulje. Ajo, për punën e suksesshme të saj, deri më tash është nderuar e shpërblyer me shumë mirënjohje e dekorata të ndryshme, siç është çmimi "Best Human Artist 2015", nga Komuniteti Evropian i Artistëve Hebrej në Paris (EJCP).

E, për aktivitetin e saj kushtuar promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, paraqitur si producente dhe regjisore në "Toka e Kelmendit" më 2007, dokumentari "Fisnikët e botës" më 2009, dokumentari "Goli Otoku" më 2010 dhe "Ti nuk je vetëm", si dhe dokumentari "Soldier" ("Ushtari") më 2014. Mrika është organizatore e "Albanian Film Week" në Nju-Jork, festival i cili prezanton filmin shqiptar në SHBA. Shqiptarja nga Kosova, Mrika Krasniqi, është nderuar si "Gruaja e Vitit 2016" nga Kongresi Amerikan, për punën e saj ndërkombëtare në fushën e artit, kulturës dhe biznesit. Dhe, jo vetëm kaq...



SHIJO EKSPERIENCEN E  
MUAJIT TE PAVARESISE



**64€ / HB**  
PERSON

*Mihpritja tradicionale*  
*Ahomodim*  
*Mengjosi*  
*Darko / Mandarino*  
*Pija e pavarosise / Lime*  
*Parkimi*





# Në 50 vjet jetë, vetëm 1 muaj martesë!

*Gjatë verës, në pleqëri e humba virgjërinë, në takimin e parë që dola me një burrë, të cilit i kishte vdekur gruaja...*

Jam 50 vjeçe dhe në pleqëri e humba virgjërinë, në takimin e parë që dola me u takuar me një burrë, të cilit i kishte vdekur gruaja para dy vjetësh. Dhe, që nga ai moment jam duke vuajtur shumë...

## SI GJETA BURRË NË PLEQËRI?

Një e afërme e familjes më tha se e njuh një burrë, të cilit i ka vdekur gruaja para dy vjetësh dhe jeton vetëm, meqë fëmijët i ka të rritur, madje të martuar dhe do ketë mundësi të më njoftoj me të. Dhe, pasi u hamenda disa ditë, e thirra në telefon dhe i thashë se pranoj të takohem me të... Kështu, rrodhi si rrodhi ngjarja, u takuam të tre: e afërmyja ime, unë dhe ai...

Por, pasi pimë kafënë, e afërmyja ime, sipas marrëveshjes me të, duhej të ngrihej e të na linte vetëm, që t'i ndërronim disa fjalë. I thashë se nuk kam pasur kurrë të dashur, se ende jam e virgjër.

Ai, i habitur, më tha: "E, si më bind ti se je e virgjër?!".

"E di unë!", ia ktheva.

"Ti e di, por unë jo!", ma ktheu.

Dhe, që t'ia dëshmoja, më tha të shkonim në banesën e tij për një kafe, meqë jetonte vetëm, e fëmijët në banesat e tyre.

Në çast, m'u turbullua mendja dhe pranova...

Rrugës teksa ecnim pranë njëri-tjetrit mendime të shumta më shkuan në

mendje: mund të bëj qejf me mua dhe të më lë; mund të bindet që jam e virgjër dhe të më marrë për grua; mund të ...

Dhe, që në takimin e parë i bëra të gjitha... edhe puthjet, edhe zhveshjen, edhe seksin, që kurrë s'e dija se si do të ndodhte...

## PAS NJË MUAJI U MARTUAM, E PAS DY MUAJSH U NDAMË!

Pas një muaji bashkë u martuam. Thënë të drejtën, martesja ishte synimi im,

sepse isha 50 vjeçe dhe nuk dija çka është fjetja me burrë!

U martuam pa ceremoni martesore.

Por, pas një jave erdhi vajza e tij në banesën tonë dhe nuk la gjë pa i thënë...

"Mezi paske pritur të na vdesë nëna e të martohesh!", i tha me zë shumë të lartë.

E, im burrë u bë si dylli në fytyrë dhe zë nuk nxori nga goja...

Një javë më vonë erdhi edhe vajza e tij e dytë, e cila jetonte në Austri. Edhe ajo nuk la gjë pa i thënë në praninë time...

Unë, këtë herë nuk u përmbajta dhe i thashë:

"O burrë, ti qenke martuar me mua pa u konsultuar me fëmijët, a?!".

Ai u mundua të arsye-tohej. Por, arsyet e tij ishin të killta. Andaj, edhe nisa të hamendem pse isha martuar...

Sidoqoftë, nga ajo ditë më rehati ndërmjet nesh nuk pat. Më shumë grindeshim sesa flinim bashkë...

Dhe, pas një muajsh martesë, i thashë troç: "Më nuk kam ven në këtë banesë!"

dhe i mora ato pak rraçe që i kisha me vete dhe u ktheva në familjen time...

Pra, 50 vjet jetë, e prej tyre vetëm një muaj martesë!

Tash, një Zot e di, a më merr më kush për grua?!

Zymrija, Has





**allure**<sup>®</sup>  
BEAUTY

# MORPHEUS8

PARAPAGUAJ 3 SEANCA

NGA  
~~1350€~~

**1000€**

DHE PËRFITO **DHURATË**

**MESOTERAPI LIFTING**

ME VLERË 250€

# Gazetari Nevrij Ademi *18 vjet pa e njohur nënën!*

*Nëna i erdhi surprizë në dasmë, ani pse e kishte braktisur qëkur ishte tetëmuajsh!*

Nevrij Ademi, gazetar nga Tetova, ka një histori jete tejet interesante, të veçantë. Qëkur ishte 8 muajsh prindërit e tij ishin ndarë. Në atë kohë e kishte braktisur e ëma. Deri në moshën 14 vjeç (tash është 25 vjeç), as që e kishte ditur se gruaja e cila e kishte rritur, në fakt, ishte njerka e tij, e jo nëna biologjike! Është rritur me gjyshërit, babanë dhe njerken. E ka një vëlla. Në moshën 12 vjeç, falë një gënjesh-

tre bërë nënës së tij se kishte parë ëndërr se nuk ishte nëna e tij, ajo i thotë: "Mos u beso ëndrrave!". Por, në mbrëmje, babai, gjyshja dhe xhaxhai i tregojnë të vërtetën... Por, edhe fqinja e tij, pastaj, i tregon se nëna e tij ishte martuar me vëllanë e saj. "Fqinja ma dha numrin e telefonit të nënës sime, por nuk kisha guxim ta merrja në telefon. Në këtë kohë nisa të shkruaj poezi. I kam 5 botime. Kryesisht, histori personale... Një ditë profesoresha më mori në kafene. Ajo e kishte thirr nënën dhe burrin e saj. Dhe, teksa afër kafenesë njerëzit zbritnin nga autobusi i linjës Shkup-Gostivar, në një moment, i them

profesoreshës: "Dua t'i flas gruas që afrohet kah ne!". "Pse?!", më tha. "Kam ndjenjën t'i flas!", ia ktheva. Dhe, për çudi, mu ajo grua është afruar afër meje... Por, pa e ditur se ajo ishte nëna ime... Pra, ai ishte takimi i parë me të... Në atë kohë unë isha 14 vjeç. Dhe, që nga ai moment kam vendosur të jetoj vetëm... Në takimin e parë i kam thënë nënës se duhet të vij në dasmën time. Ajo më tha se nuk do të vij në dasmë. Por, ajo erdhi në ceremoninë e martesës sime dhe atmosfera u bë edhe më e ndjeshme dhe nuk do ta harroj kurrë", thotë Nevrij Ademi, për ditën më të rëndësishme të jetës së tij.

# "I vdekuri" pas 24 vjetësh lajmërohet i gjallë!

*Abedin Avdiu, nga Mitrovica, ishte 13 vjeç kur u rrëmbye më 1999, gjatë luftës në Kosovë. Rrëmbyesit, bashkë me 20 fëmijë të tjerë, i kishin dërguar në Itali.*

*E, pas 24 vjetësh kontakton me familje...*

Lufta në Kosovë më 1999 la gjurmë të thella në popullin e Kosovës. Por, këtë më së miri e dinë familjet që i kanë humbur të dashurit e tyre.

E, ndër ato familje, janë familjet që ende të dashurit e tyre i kanë të zhdukur.

Një i zhdukur, qe 24 vjet, ishte edhe Abedin Avdiu, nga Mitrovica. Në atë kohë, së bashku me 20 fëmijë të tjerë, ishte rrëmbyer në Mitrovicë.

Duket si skenar filmi, por Abedin Avdiun familja e konsideronte të vdekur...

Por, pas 24 vjetësh, pra në moshën 37 vjeç, ai u shfaq në ekranin televiziv, teksa e kërkonte familjen e tij...

Dhe, falë emisionit "Pa gjurmë", transmetuar në Televizionin "Report TV", familja Avdiu mësoi lajmin se djali i tyre, të cilin e dinin të vvarë, ishte gjallë.

Familja e tij, konkretisht babai, Ramadan Avdiu, u befasua me videon, të cilën ia surprizoi moderatorja e programit, Odeta Dume.

Ndërkaq, djaloshi 37-vjeçar, i mbytur

në lot, nuk mund të besonte se, më në fund, e kishte gjetur familjen...

## SI U GJEND ABEDINI NË ITALI?

Abedini, bashkë me 20 fëmijë të tjerë, u dërguan në Itali nga rrëmbyesit, të cilët i detyronin të vidhnin.

U rrit në një jetimore në Itali.

Fati i tij i mirë bëri që ai t'u shpëtonte rrëmbyesve e t'i denonconte në polici autorët.

Më vonë vendosi ta kërkojë familjen e tij.

Bashkimi i shumëpritur mes familjes Avdiu dhe djalit të tyre, Abedinit, pas 24 vjetësh zhdukjeje, i ka emocionuar jo vetëm protagonistët e kësaj ngjarjeje, por të gjithë ata që kanë pasur rastin të dëgjojnë për këtë histori jete. Por, "filmi" nuk ka përfunduar, meqë edhe 19 fëmijë të tjerë ku kanë mbetur?!



# Vajzat nuk më bëjnë hesap as për qen!

*Jetoj në Suedi. Jam nënë e dy vajzave. Por, kurrënjëherë nuk më kanë respektuar si nënë! Zoti ua ktheftë vajzave të mia, siç po ma bëjnë ato mua!*

I kam dy vajza, të shëndosha si drita. Por, Zoti nuk u ka dhënë mend dhe nuk më bëjnë hesap për nënë! Madje, as për qen!

Dy vajzat e mia, dritat e syve të mi, të cilat i kam mbajtur 9 muaj në bark, i kam qitur në dritë dhe i kam rritur me shumë mundime, nuk kanë pasur kurrë respekt moral ndaj familjes, e as nënës së tyre!

Zoti i ka falur të shëndosha, por s'kanë mend, e as kurrë s'kanë me pasur mend, se njeriu në jetë gabon një herë e jo 100 herë!

## **VAJZAVE TË MIA KURRË S'UA BËJ HALLALL!**

Çka më kanë bërë vajzat e mia në jetë kurrë, s'kam me ua bërë hallall!

As s'dinë që ka Zot, as familje, as s'më respektojnë mua, e as babën e tyre!

Shkurt e shqip: Kanë bërë dhe bëjnë çka duan, kanë shkuar dhe shkojnë ku duan, janë martuar me njerëz rrugaçë, që i kanë njohur në internet,

të droguar, të cilët i terrorizojnë sipas qejfit të tyre!

Babai është munduar t'i bindë se nuk e kanë mirë, se nuk bën kështu, por kot...

Është munduar t'i bindë për të mirën e tyre. Por, as babën e tyre, e lëre më mua, kurrë s'na kanë dëgjuar e respektuar!

Sepse, nëse ua kemi thënë një fjalë, ato na i kanë thënë 100!

Sa e sa herë, para martesës së tyre, janë larguar nga shtëpia, pa u paraqitur as në telefon. Dhe, tek pas disa ditësh janë kthyer në shtëpi!

E, kur i kemi pyetur ku kanë qenë, përgjigja e tyre ishte shkurt: "Jemi të rritura dhe dimë çka bëjmë!"

## **... I KANË BËRË 100 TË ZEZA!**

E, meqë kanë pasur liri të plotë prej neve, familjes, pse me na i bërë 100 të zeza?!

Veç pse kemi qenë prindër të mirë, apo...?!

Kur kanë qenë pa u martuar, sa herë që kemi shkuar në Kosovë, veç probleme na shkaktonin.

Na e prisheshin pushin, na e bënin me helm...

Si nënë, tërë natën rrija pa gjumë, duke pritur kthimin e tyre...

Por, ato vinin tek në mëngjes dhe tërë ditën flinin!

Bile, herën e fundit, para se të marto-heshin, kur jemi kthyer nga Kosova në Suedi, e kanë paraqitur babanë e tyre në polici, kinse gjatë qëndrimit sa ishim në Kosovë i ka mbajtur mbyllur në shtëpi dhe nuk i ka lënë as me dalë në rrugë!

E, e vërteta ishte krejt tjetër. Ato më shumë kanë fjetur nëpër hallk sesa në shtëpinë e tyre!

Sidoqoftë, me të gjitha mënyrat jemi munduar t'u ndihmojmë, por kot...

Kanë hyrë rrugëve të këqija dhe kurrë nuk janë përmirësuar...

Sidoqoftë, çdo ditë e luti Zotin, këto që po na i bëjnë mua e burrit tim, ua kthefshin fëmijët e tyre!

**M. V., Suedi**

Sa kilogramë dërshironi të humbni?

**10-15**  
ME  
**20 seanca**

~~60,000 Lek~~

**48,000 Lek**

Kurse 12,000 Lek  
me **20% ulje**

Sa kilogramë dërshironi të humbni?

**5-10**  
ME  
**15 seanca**

~~47,000 Lek~~

**37,600 Lek**

Kurse 9,400 Lek  
me **20% ulje**

Sa kilogramë dërshironi të humbni?

**15-25**  
ME  
**35 seanca**

~~87,500 Lek~~

**70,000 Lek**

Kurse 17,500 Lek  
me **20% ulje**



# Ditën e dasmës u vranë krushqit dhe nuset!

*Pak kilometra larg Ferizajt, ndodhet njëri nga fshatrat më të thella malore, Pleshina, fshat i historive të shumta...*

Pleshina është fshat jo shumë kilometra larg Ferizajt. Fshati është i pasur me komplekse të bukura malore, atraktive dhe me natyrë magjepsëse. Por, ajo se çfarë e bënë të veçantë e të padëgjuar më parë, janë emërtimet e zonave, bazuar në histori të vërteta.

E, njëra nga historitë e ndodhura në këtë fshat është ajo e "Varreve të krushqve".

Banorët e moshuar të këtij fshati gjithsecili di për rastin kur në ditën e dasmës janë vranë krushqit ndërmjet vete, por edhe nuset!

Ndryshe, ky fshat paraqet një thesar të pasur të trashëgimisë kulturore, të periudhave të ndryshme historike dhe ka një popullsi të dendur.

Radio,  
Lajme, Moti,  
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin  
**shkabaj** për Android

ANDROID APP ON  
Google play

## TRAJTIMET ESTETIKE TË KOKËS DHE QAFES



Mbjellja e  
Flokëve



Blepharoplasty



Facelift



Otoplasty



Rhinoplasty



Ngritje e  
vetullave



Foxy Eyes



Chin  
Liposuction



Chin Implant



Cheek Bones  
Implant



Cantopexy



Lip Lift

Rr. Zef Jubani, Veternik - Prishtinë (Hyrja për në autostradë)

+383 (0) 45 707 744 | +383 (0) 43 707 744



Flash

## E paharrueshmja Aida Baraku

Nuk e kemi parë që shumë vjet, por fytyra e Aida Barakut veç sa zbukurohet...

Aida Baraku, dikur ylli i muzikës te shqiptarët, ka vite që nuk duket gjëkund!

Ndërkohë, bashkëshorti i saj, Armend Rexhepagiqi, i është kthyer muzikës dhe daljeve publike.

E, Aida vazhdon të qëndrojë larg çdo paraqitjeje...

Këngëtarja e hitit "Titanik" shkruan tekste për këngët e të tjerëve, por që shumë vjet jo më për vete.

Në një foto rasti nga përditshmëria, Aida duket yll: e bukur, pa grim, pa asnjë rrudhë...



Në vend se të kem punë me djem...

*Gjëja që më nevrikos më së shumti është se më vardisen burrat e martuar! Biznesmenë të ndryshëm më bezdisin, duke më thënë se do t'më menaxhojnë, do t'i paguajnë të gjitha shpenzimet nëse do jem më të...*

Jam 22 vjeçe, e lindur e rritur në Suedi. Shpesh vij në Kosovë e Shqipëri. Jam

## Jam në zor nga burrat e martuar!

e interesuar të depërtoj në skenën e modelimit, sepse kam trup e pamje modeleje. Por, sa herë që jam në kontakt me ndonjë biznesmen, që në hapat e parë më zhgënjën me fjalët: Do të të menaxhoj, do t'i paguaj të gjitha shpenzimet nëse do të jesh me mua... E, kjo më nevrikos, më bën të ndihem

keq, sidomos nëse biznesmeni që m'i ofron kushtet e tilla është i martuar, meqë nuk jam për pazar, por për jetë që e meritoj. Andaj, kam bërë çka kam bërë, nuk pendohem për asgjë, meqë jam e vetëdijshme për gjërat që bëj në jetë.

**Vitorja, Suedi**

# KOMPLEKSI CIMA RESIDENCE

+383 49 509 090



SHTËPIA E ËNDRRAVE  
+383 49 601 080

CALLING



Numero 16




Message



Take the call

## LAGJJA PANORAMA





**Duke pritur  
liberalizimin  
e vizave**



**Po të  
kënaqka  
uji...**



**Përgatitja  
për dimër...**



**m'than kur te rritesh ,  
ki mu ba deputet !!!!!**

**Deputeti  
i ardhshëm...**



**DENTFIX**  
ORDINANCA STOMATOLOGIJE



## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

*kontaktoni në këtë email adresë:*

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### **A ka kuptim të ndahem nga burri?**

Zonja magjistare, kam shumë besim në ty. Të kam shkruar para pesë vjetësh se a ia vlen të martohem me burrin që e kam sot...

Unë u fejova dhe u martova me burrin që jam tash. Prita që ta dua, por nuk po mund ta dua si kam menduar...

Tani jam bindur se e dua personin që e kam pasur dikur dhe me të jam takuar, edhe pse është martuar.

Në martesë nuk jam e lumtur. Por, edhe nëse ndahem nga burri dhe e marrë atë që e dua, ai është martuar dhe nuk e besoj se ka për të mbajtur fjalën - ta lë gruan për mua, meqë e kanë një fëmijë. Si të veproj?

**“E palumtura”**

### **Përgjigje:**

*Nuk shoh te ti martesë me personin që e do. Ju veç keni qenë në lidhje dhe lidhja juaj është shkatërruar nga veprimi i tij, andaj nuk të them besoji. Mos u ndajë nga burri, sepse shoh dështim pastaj. Por, nëse ti ke vendosur të*

*ndahesh për arsye se nuk je e lumtur me burrë, kjo është histori tjetër.*

### **E zgjedha vetë burrin, tash jam e zhgënjyer!**

Jam e martuar, 27-vjeçare, jetoj në Mitrovicë. Kam disa dyshime në veten time apo edhe mund të më kenë bërë diçka, kur dola të shihem me djalin që tani e kam burrë. Dola të shihem me të dhe mu duk i bukur, i pashëm. Ditën e parë që kemi dal si të fejuar më është dukur krejt tjetër dhe nuk kam pasur më dëshirë të takohem me të, por pasi gabova u desh ta mbulojë gabimin tim, duke u bërë gruaja e tij. Të lutem, a do jetoj me të deri në fund të jetës?

**“Me ty, e dëshpëruar”**

### **Përgjigje:**

*E ke pritur gjatë fejesës, e dëshira për t'u fejuar ka bërë që ai të të duket më i bukur në botë! Kjo ndodh edhe te shumë meshkuj, e jo vetëm te femrat. Dhe, pastaj, shohin se kanë gabuar. Por, realisht, disa gabime*

*janë të vonuara. Tash nuk je e gatshme dhe as e guximshme për ndryshime. E, ajo që unë shoh te ti është se do të jetosh me të dhe do i keni tre fëmijë.*

### **E kam zënë burrin duke më tradhtuar!**

Përsëritet, shpresoj t'më ndihmoni!

Jam e martuar, por nuk kaloj mirë me burrë, sepse më ka tradhtuar.

E kam zënë në vepër, por nuk e pranon.

E kam falur, duke marrë vendim ta vazhdoj jetën si prej fillimit. Por, prapë punët nuk po më shkojnë mirë...

**“Lena”**

### **Përgjigje:**

*Sikur ta kishe zënë në vepër, ai patjetër do ta kishte pranuar realitetin. Fakti që nuk e ka pranuar do të thotë se ti je informuar nga dora e dytë apo e tretë për rastin. Mirë është që nuk e ka pranuar, sepse kur burri ia pranon gruas se ka femër tjetër, de fakto, martesa merr fund.*

*Në këtë rast, po ta ketë pranuar fajin, ti ose do ishte dashur të ndahesh prej tij ose do ia kishe pranuar tjetrën. Pra, më mirë që nuk e ka pranuar.*

*E, kjo të jep të kuptosh se nuk është i interesuar të bëjë ndryshime në jetën bashkëshortore...*

### **A ka gjasa që i fejuari t'më rikthehet?**

Përsëritet zonjë, jam vajzë, 30-vjeçare. Kam pasur një fejesë që më ka dështuar,

por kam shpresa se ai do më kthehet përsëri, sepse më ka dashur shumë, e kjo besoj se i jep të drejtën atij të rifillojmë nga e para.

Të lutem, çka sheh syri yt për rastin tim?

**“E vuajtura”**

**Përgjigje:**

*Nuk mund të kthehet jeta nga e para asnjëherë! Pas çdo mbarimi më kurrë nuk ekziston një fillim i ri, sepse të rifillohet në të njëjtën pikë, pasi ka ndodhur diçka e keqe, s’ka mundësi.*

*E keqja mbetet e keqe dhe ajo mund të heshtët, por nuk mund të largohet nga shpirti...*

*Rasti yt ka qenë tronditës për të fejuarin, sepse ai ka gjetur të dhëna të sakta dhe bindëse se ti ke pasur lidhje të dyfishtë dhe kjo e ka dëshpëruar, pa marrë parasysh se të ka dashur...*

*Andaj, nuk shoh se do jeni bashkë.*

**Nuk po e njoh veten!**

Jam vajzë, 20-vjeçare, kam shumë probleme me veten. Nuk kam asnjë orientim dashurie. Kohëve të fundit po shoh se kam më shumë ambicie të jem në shoqëri me femra sesa me meshkuj!

Kam pasur disa oferta nga meshkuj të ndryshëm, por nuk kam pasur ndjenja për t’i pranuar...

Të lutem, çka po ndodhë me mua?

**“Lesbikja”**

**Përgjigje:**

*Nëse të pëlqen shoqëria me vajza, nuk do të thotë se je lesbike. Unë besoj se me kohë do orien-*

*tohesh kah meshkujt, andaj rri në shoqëri sa më shumë me ta, sepse kështu e kërkon edhe Zoti i madhërishëm.*

*Dhe, sa më shumë që të rri në shoqëri me botën mashkullore, aq më shumë do të shtohet ndjenja për meshkujt...*

*Në fund të fundit, më së miri është të konsultohesh me një psikolog, nga i cili edhe do i marrësh këshillat më adekuate...*

**A do e gjej fatin në pleqëri?**

E nderuara magjistare, jam 50-vjeçare, nga Prishtina.

A do të kem fat, edhe pse jam në moshën kur asgjë nuk po më shkon së mbari?

Në dashuri nuk kam fare fat. Kam përshtypjen se meshkujt po ikin prej meje!

A do e gjej fatin në pleqëri?

**“Hana e plotë”**

**Përgjigje:**

*Mosha jote është problem serioz për martesë, sepse të ka ikur gjenerata. Brezat tu kanë bërë zgjidhje në 99 për qind të rasteve, andaj është problem ta gjesh veten, por sërish do të gjendet diçka edhe për ty...*

*Unë shoh se do të kesh fatin të gjesh burrë edhe në këtë moshë që ke. Deri kah muaji mars i vitit të ardhshëm do e gjesh fatin e jetës...*

**Pse më pëlqen të argëtohem e jo të martohem?**

Jam 21-vjeçare, i kam pasur tri lidhje deri më tani.

Kam shumë oferta për martesë, por nuk kam ndjenja për martesë! Të gjithë befasohen

## PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

me mua kur ua them këtë gjë... Çka po ndodh me mua?

**“Tri lidhje”**

**Përgjigje:**

*Unë shoh se te ti kjo vjen si rezultat i dëshirës për ta jetuar jetën pa obligime.*

*I përket llojit të femrës që nuk do mbyllje dhe ky është vizion progresiv. Ideja jote vizionare tregon se ti e di që me martesë tradicionale bëhesh amvise e me fëmijë dhe këtu ndalon ëndrra rinore.*

*Ti po kërkon dritë, por s’ka kush të ta jep, s’ka kush të ta hapë atë dritare.*

*Andaj, lufto për dije dhe provo t’i realizosh ambiciet tua!*

**Çka do të ndodh me jetën time si maturante?**

Jam nxënëse, maturante, e fejuar.

Pres të martohem.

Kam frikë se nuk do prano-hem në fakultet.

Në familjen që do të shkoj, të gjithë janë të shkolluar...

**“Jehona”**

**Përgjigje:**

*Është fat që janë të shkolluar, sepse duke qenë të tillë do të regjistroshe edhe ti në fakultet dhe kështu do të jesh edhe një e shkolluar në mesin e të shkolluarve. Shoh se krahas martesës do e arrish edhe dëshirën e shkollimit...*





**SHERWOOD**  
exclusive Lara

Shijoni pushimet tuaja komode gjatë  
gjithë vitit me pishina të ngrohta



[www.sherwoodhotels.com.tr](http://www.sherwoodhotels.com.tr)